

VENDIM
Nr.364, datë 4.5.2011

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË VLERËS MINIMALE TË SIPËRFAQES SË ZONËS SË LEJUAR MINERARE DHE TË VLERËS MINIMALE TË INVESTIMIT E TË PRODHIMIT PËR NJË LEJE MINERARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pikat 3 e 8, dhe 56, pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimi i kriterëve për vlerën minimale të sipërfaqes të zonës së lejuar minerare dhe për vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit ka karakter teknik, ekonomiko-financiar, dhe mbështetet në:

a) përcaktimin e sipërfaqeve të mjaftueshme të zonës së lejuar minerare, për gjetjen e rezervave minerare për aktivitete të mëtejshme shfrytëzimi dhe përpunimi të mineralit;

b) interesin për llojin e mineralit sipas grupeve të mineraleve;

c) moscopëtimin e territoreve me strukturë të njëjtë gjeologo-minerare;

ç) rregullat teknike të realizimit të aktivitetit të kërkim-zbulimit;

d) mundësinë e gjetjes së rezervave të reja minerare;

dh) leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme për një vendburim të madh, grup vendburimesh të mesme e të vogla apo shfaqjesh minerale në një zonë të lejuar të kërkim-zbulimit;

e) përfshirjen për aktivitet kërkim-zbulimi të kapitaleve të mjaftueshme financiare dhe profesionale;

ë) realizimin e investimit në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

f) krijimin e mundësive për rivlerësim të vendburimeve dhe objekteve të njohura.

2. Vlera minimale e sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe vlera minimale e investimeve për çdo kilometër katror të kësaj zone për lejet e kërkim-zbulimit, sipas grupeve të mineraleve, jepen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kriteret për vlerën minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare, vlerës minimale të investimit dhe vlerës minimale të prodhimit vjetor për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit kanë karakter teknik, ekonomiko-financiar dhe mbështeten në:

a) përcaktimin e sipërfaqeve të mjaftueshme të zonës së lejuar minerare, për zhvillimin normal të aktiviteteve të shfrytëzimit dhe përpunimit të mineralit;

b) kushtet e vendndodhjes, ndërtimin gjeologjik të objektit apo vendburimit;

c) parametrat sasiorë dhe cilësorë të objektit apo vendburimit, përmasat e trupave minerarë apo vendburimit dhe marrëdhëniet e tij me elementet e infrastrukturës;

ç) rregullat teknike të realizimit të aktivitetit të shfrytëzimit;

d) investimet e nevojshme për realizimin e programit të prodhimit dhe të të gjitha punimeve e proceseve të nevojshme dhe që kushtëzohen nga kriteret tekniko-minerare;

dh) kostot, çmimet, të ardhurat e pritshme dhe leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme për një trup minerar apo vendburim të një zone të lejuar minerare;

e) përfshirjen për aktivitet shfrytëzimi të kapitaleve të mjaftueshme financiare dhe profesionale;

ë) realizimin e investimit në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe

planifikimin e territorit;

f) konkurrueshmërinë e aktivitetit të shfrytëzimit me kushtet e tregut të brendshëm, rajonal apo ndërkombëtar.

4. Vlera minimale e sipërfaqes të zonës së lejuar minerare, vlera minimale e investimeve për realizimin e prodhimit minimal vjetor dhe vlera minimale e prodhimit vjetor për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit jepen në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha